

04.07.2017

Qeveria e Republikës së Maqedonisë

Plan 3-6-9

Kahja e reformave të cilat Qeveria e Republikës së Maqedonisë i propozon dhe të cilat janë të vendosura në “Planin 3-6-9”, burojnë nga Programi për punë të Qeverisë 2017-2020, ndërsa merr gjithashtu parasysh edhe Marrëveshjen Politike të Përzihos dhe ndjek rekomandimet që dalin nga takime të nivelit të lartë me përfaqësues të institucioneve të BE-së, udhëzimet e Komisionit Evropian rreth Reformave Urgjente Prioritare (2015), Rekomandimet e grupit të lartë të ekspertëve për çështje sistimore të sundimit të ligjit lidhur me ndjekjen e komunikimeve (2015), si dhe një sërë rekomandimesh drejtuar Qeverisë gjatë viteve të fundit nga organeve të Këshillit të Evropës (Komisioni i Venedikut, GREKO), rekomandimet e OSBE/ODIHR, gjetjet dhe rekomandimet nga Raportet vjetore të Komisionit Evropian, duke i përfshirë edhe ato nga Dialogu Aderues në Niveli të Lartë, konkluzionet e dialogut ministror për Programin për reforma ekonomike, konkluzionet nga mbledhjet e rregullta të organeve të Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim, dokumenti i përgatitur nga një grup organizatash civile i titulluar si “Propozim për Reforma Urgjente Demokratike” (Bluprint) dhe rezultate nga konsultimet me shoqërinë civile.

Masat e propozuara nga grupi i parë, të përfshira në këtë Plan, duhet të realizohen deri në mbajtjen e zgjedhjeve lokale. Masat tjera të cilat më detajisht do të përpunohen nga ana e institucioneve kompetente, do të hyjnë në grupin e dytë dhe të tretë të masave të cilat duhet të realizohen deri në nëntor/dhjetor, apo para mbajtjes së Këshillit të BE-së në dhjetor, si dhe ato që duhet të realizohen deri në mars të vitit të ardhshëm, apo deri në publikimin e radhës të Raportit të rregullt të Komisionit Evropian për Maqedoninë.

Masat do të mbështeten në qëllimet dhe parimet në vijim,

Në fushën e zgjedhjeve, Qeveria i pranon rekomandimet e OSBE/ODIHR dhe Komisionit të Venedikut dhe të njëjtat do ti zbatojë në afat të shkurtër, të mesëm dhe të gjatë. Në afat të shkurtër masat do të fokusohen në mbështetjen e Komisionit Shtetëror Zgjedhor dhe konsolidimit të brendshëm si dhe përforcimit të kapaciteteve të tyre, në kontekst të përgatitjes të zgjedhjeve lokale, duke përfshirë këtu edhe azhurimin e Listës Zgjedhore, edukimin e administratës zgjedhore dhe të votuesve.

- Miratim i një Deklarate nga Qeveria me sugjerim se, lidhur me zgjedhjet, nuk do të lejohet frikësim dhe presion ndaj administratës, me inkurajim për paraqitjen e rasteve eventuale të presionit deri tek organet kompetente ku do të pasojë suspendim i personave udhëheqës në qoftë se vërtetohet keqpërdorim
- Në qoftë se në Raportin e radhës të OSBE/ODIHR konstatohet informim i pabalancuar gjatë procesit zgjedhor, e njëjta do të jetë kusht për shkarkimin e drejtorit të Shërbimit radiodifuziv publik – Radio-televizioni i Maqedonisë
- Ekipim i departamentit ligjor të Komisionit Shtetëror Zgjedhor (KSHZ) me qëllim që të mund të jepen në kohë mendime pas ankesave të dorëzuara
- Ekipim i sektorëve për Listën zgjedhore dhe IT në KSHZ me qëllim të rritjes së efikasitetit të Komisionit
- KSHZ të përgatisë raport për ankesat e dorëzuara gjatë procesit zgjedhor si bazë për evaluim të sistemit të ankesave

- Miratim i udhëzimit për ndalesë të shfrytëzimit të resurseve shtetërore nga ana e pjesëmarrësve dhe kandidatëve gjatë periudhës zgjedhore
- Qeveria do të miratojë masa me të cilat do të parandalojë pjesëmarrësit dhe kandidatët të shfrytëzojnë resurset shtetërore gjatë periudhës zgjedhore (shfrytëzim të makinave zyrtare, reprezentacionit, hapësirave zyrtare dhe kapaciteteve administrative)
- Miratim gradual i akteve të nevojshme nënligjore në përputhje me rekomandimet e OSBE/ODIHR dhe ekspertit të Komisionit të Venedikut
- Rekomandohet që seancat e KSHZ-së të jenë të hapura për publikun, në drejtim të rritjes së transparencës në punën e tyre
- Miratim i një Vendimi për zgjedhje të përhershme për hapësirën ku është vendosur KSHZ
- KSHZ në bashkëpunim me MPB-në të vazhdojë me azhurimin e mëtejshëm të Listës Zgjedhore

Në fushën e punës së Parlamentit, Qeveria do të fokusohet në mbështetjen e plotë të të gjitha masave për kthimin e ambientit demokratik në këtë institucion kyç, përmes dialogut politik dhe bashkëpunimit me të gjitha partitë parlamentare, e në veçanti me opozitën. Qeveria do jep kontributin e saj lidhur me sigurimin e kushteve për zbatimin e plotë të Rekomandimeve të dakorduara pas ngjarjeve të pakëndshme të datës 24/12/2012, dhe lidhur me ngjarjet e dhunshme të datës 27/04/2017. Qeveria, partnerët e koalicionit dhe shumica në Parlament, në bashkëpunim të hapur dhe të sqartë me opozitën, do të kujdesen që funksioni mbikëqyrës i Parlamentit dhe i organeve të Parlamentit mbi punën e Qeverisë dhe shërbimeve të saja të sigurisë dhe inteligjencës, të jetë i rregullt dhe rutinor, me shkallën më të lartë të mundshëm të transparencës dhe përfshirjes së përfaqësuesve të shoqërisë civile.

- Për përforcimin e llogaridhënies, Qeveria i rekomandon Kuvendit, krahas seancave të rregullta të pyetjeve të deputeteve, të mbahen edhe seanca tematike të pyetjeve të deputetëve një herë në javë në kohëzgjatje prej një ore
- Elaborim i domosdoshëm i propozim ligjeve nga ana e Qeverisë në nivel ekspertësh para organeve të Kuvendit
- Përforcim i rolit dhe pjesëmarrjes së përfaqësuesve të shoqërisë civile në punën e organeve punuese të Kuvendit
- Kthimi i rolit thelbësorë mbikëqyrës të Komisionit për mbikëqyrje ndaj punës së Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim dhe të Agjencisë së Inteligjencës, përmes mbledhjeve të rregullta tek të cilat detyrimisht dhe në mënyrë aktive do të marrin pjesë DSK dhe Agjencia i Inteligjencës
- Kthimi i rolit thelbësor mbikëqyrës të Komisionit për mbikëqyrje të zbatimit të masës së veçantë hetimore për ndjekjen e komunikimeve nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme, Drejtorisë së Policisë Financiare, Drejtorisë Doganore dhe Ministrisë së Mbrojtjes, përmes takimeve të rregullta në të cilat detyrimisht dhe në mënyrë aktive do të marrin pjesë të gjitha institucionet kompetente

- Kyçja e Komisioneve parlamentare për mbikëqyrje të shërbimeve të inteligjencës në projektin për reformë të shërbimeve të inteligjencës dhe sigurisë
- Riaktivizim i Klubit të deputeteve femra
- Riaktivizimi i Komisionit të përhershëm anketues për të Drejtat e Njeriut
- Rritja e rolit të opozitës në punën e Kuvendit përmes mundësisit të shumicës dhe udhëheqje të një numri të konsiderueshëm të komisioneve parlamentare

Qeveria do të bëjë gjithçka nga ana e saj, për të siguruar bashkëpunim **(kohabitim) me Presidentin e Republikës së Maqedonisë**, si dhe funksionim pa pengesë të të gjitha institucioneve shtetërore me respektim të plotë të obligimeve të definuara kushtetuese dhe ligjore dhe përgjegjësive të tyre.

- Fillim i konsultimeve me Presidentin e Republikës së Maqedonisë për plotësimin e vendeve të lira në përfaqësitë diplomatike
- Zgjedhja e anëtarit të Këshillit të Prokurorëve Publik, i cili zgjidhet me propozim të Kuvendit
- Zgjedhja e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, të cilit i përfundon mandati

Në fushën e implementimit të **Marrëveshjes së Ohrit**, në frymën e kohezionit, Qeveria u dakordua për avancimin e implementimit të elementeve legjislative

- Miratimi i një Propozim Ligji për përdorimin e gjuhëve nga ana e Qeverisë, i cili me tej do të dorëzohet për konsultime në Komisionin e Venedikut

Shoqërinë Civile, Qeveria do ta trajtojë si partner të barabartë dhe korrigjues të vendimeve të saj, me të drejtë të plotë shoqëria civile të merr pjesë në ndërtimin e politikave, të sugjeroj dhe të kritikojë. Qeveria ka për qëllim që dialogu me shoqërinë civile të jetë i vazhdueshëm, transparent dhe plotësisht gjithëpërfshirës.

- Krijimi i Këshilli funksional për bashkëpunim mes Qeverisë dhe sektorit civil, përmes ndryshimit të Vendimit për formim të Këshillit për bashkëpunim dhe përsëritje të procesit për zgjedhje të anëtarëve të Këshillit, në konsultim me sektorin civil
- Vlerësim i aktualitetit të masave dhe aktiviteteve të përfunduara nga Strategjia për bashkëpunim të Qeverisë me sektorin civil (2012-2017)
- Rritje të numrit minimal të ditëve për konsultim rreth RVER (Regjistri i Vetëm Elektronik i Rregulloreve) nga 10 ditë në 20 ditë, me ndryshim të Rregullores për punë të Qeverisë
- Vendosje e mekanizmit me qëllim të sigurimit që para se gjithash në procedurë Qeveritare, të hyjnë ato ligje dhe akte nën ligjore që kanë kaluar procedurën e RVER dhe shoqërohen me të gjitha aktet e nevojshme mbështetëse

- Hetime kundër frikësimit dhe presionit ndaj organizatave civile (respektivisht të hetohen të gjitha denoncimet për gjuhë të urrejtjes, sulme, presion)
- Vendosja e bazës elektronike të të dhënave për mjete të ndara për shoqëritë civile nga Buxheti i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për periudhën 2012- 2016, në të cilën do të vendosen të gjitha vendimet e marra

Në fushën e **mediave** Qeveria do të ndërtojë partneritet me asociacionet dhe sektorin civil, me qëllim të liritimit të hapësirës mediatike nga çfarëdo lloj ndikimi institucional apo individual, përfshirë këtu edhe varshmërinë financiare. Qeveria ndalon reklamimin komercial, do të përforcojë dhe profesionalizojë shërbimin radiodifuziv publik dhe do të hap për publikun e gjerë të gjitha informacionet me karakter dhe interes publik.

- Miratimi i një Deklarate për shprehje të vullnetit të fortë politik dhe mbështetjes nga ana e Qeverisë dhe institucioneve për zbatim të vazhdueshëm të Kodit të etikës për raportim mediatik
- Miratimi i një vendimi Qeveritar për ndalimin e reklamave qeveritare tek transmetuesit privat (me përjashtim të mediave sociale) dhe transmetimin e komunikimit me qytetarët përmes shërbimit radiodifuziv publik
- Publikimi i të gjitha shpenzimeve për reklamim të Qeverisë dhe shpjegim të kriteve për përzgjedhje të mediave në periudhën 2008-2017, në formatin e dorëzuar nga Komisioni Evropian
- Organizim konsultimi publik me mediat, shoqatat e mediave dhe organizatave të shoqërisë civile
- Përgatitje e propozim - ndryshimeve të Ligjit për media dhe Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, që do të mundësojnë zbatimin e Kodit të etikës për raportim gjatë dhe pas zgjedhjeve, si dhe për përforcimin e pavarësisë dhe kapacitetit të rregullatorit të medias dhe shërbimit radiodifuziv publik
- Përgatitjen e propozim-ndryshimeve të rregullores ligjore të cilat do të mundësojnë zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Agjencionit për Shërbime audiovizuale dhe shërbime mediatike, në bazë të meritës
- Përgatitje e një përmbledhjeje të të gjitha rasteve të mëparshme të presioneve dhe sulmeve fizike dhe verbale, gjuhës së urrejtjes, etj ndaj gazetarëve
- Mbajtje brifingu javor të Qeverisë me mediat

Reforma e Administratës Publike (RAP) në afat të shkurtër, të mesëm dhe të gjatë është një nga prioritet kyçe të Qeverisë, ku pikënisja do të jetë tek definimi i Strategjisë gjithëpërfshirëse dhe cilësore për RAP, në drejtim të depolitizimit dhe profesionalizimit të plotë të administratës, dhe ngritjen e një administrate të orientuar drejt shërbimit e cila do të funksionojë dhe do të punojë në kushte të përmirësuara pune, duke përdorur të gjitha mundësitë moderne për qasje përmes e-qeverisë, e-shërbime dhe interoperabilitet.

- Qeveria do të sjellë vendim për deklasifikim të të gjitha dokumenteve me interes për publikun
- Shfuqizim të vendimit për përcaktimin e kompensimit për shpenzime materiale për informacion të dhënë nga poseduesit e informacioneve

- Revidim i Regjistrit të mbajtësve të informacioneve me karakter publik dhe të personave kompetent për qasje të lirë në informacione me karakter publik në të gjitha institucionet dhe detyrim për institucionet për publikim të të gjitha dokumenteve me karakter publik në web faqet e tyre
- Publikim të rrethorave të ditës të seancave të Qeverisë në web faqe
- Krijim i grupeve tematike të punës dhe fillim me rishikimit të Propozim-Strategjisë për Reformë të Administratës Publike dhe Propozim-Plani të Veprimit, me përfaqësues të institucioneve dhe sektorit civil dhe në pajtueshmëri me komentet e dhëna nga SIGMA
- Vazhdim me procesin e azhurimit të Regjistrit të të punësuarve në sektorin publik në mënyrë që të publikohet numri i përgjithshëm i të punësuarve sipas sektorëve
- Fillimi i një dialogu gjithëpërfshirës rreth Propozim-Programit për Menaxhim me Financat Publike 2018-2021

Në fushën e **reformave gjyqësore**, Qeveria pranon vërejtjet dhe rekomandimet e Komisionit Evropian dhe të Këshillit të Evropës (Komisionit të Venedikut dhe GRECO), me çka në afat të shkurtër, të mesëm dhe të gjatë angazhohet për ndërtimin e një sistemi gjyqësor të pavarur, të paanshëm, profesional dhe efikas. Në afat të shkurtër, Qeveria do të bëjë një rishikim të plotë të Propozim Strategjisë për reformën e sistemit gjyqësor dhe do të fillojë ndërtimin e një atmosfere të gjyqësorit të lirë, pa presione politike, me qëllim që të sigurojmë hapësirë edhe për ndryshimet e nevojshme legjislative në afat të mesëm dhe në afat të gjatë.

- Shfuqizimi i Ligjit për Këshillin për verifikim të fakteve dhe përgjegjësisë disiplinore të gjyqtarëve dhe përgatitje e ndryshimeve dhe plotësimeve të Ligjit për Këshillin Gjyqësor, për shkak të kthimit të kompetencave tek Këshilli Gjyqësor
- Qeveria inkurajon Këshillin Gjyqësor të nxis gjyqtarët për të gjitha rastet eventuale të presionit politik ose të ndonjë lloji tjetër presioni, menjëherë të informojnë Këshillin Gjyqësor, Shoqatën e Gjyqtarëve dhe mediat, kurse në qoftë se presioni vjen nga Prokurori Publik, në atë rast menjëherë të informohet Këshilli i Prokurorëve Publik dhe mediat. Nëse presioni vjen nga një anëtar i Këshillit Gjyqësor, menjëherë të informohet Kryetari i Këshillit Gjyqësor dhe mediat.
- Formimi i grupit të punës për hartimin e Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Gjykata dhe Ligjit për Këshill Gjyqësor në pjesën e procedurës për përgjegjësi disiplinore të gjyqtarëve, bazat e përgjegjësisë disiplinore, masat disiplinore dhe vlerësimin e gjyqtarëve
- Formimi i një grupi të ri pune për të rishikuar propozim Strategjinë për reformë të sektorit të drejtësisë, siç rekomandohet nga Komisioni Evropian, Komisioni i Venedikut dhe GRECO
- Mbajtja e konsultimeve të rregullta me KE-në lidhur me tekstin e propozim-Strategjisë
- Organizim i një debati publik lidhur me propozim Strategjinë për reformë të sektorit të drejtësisë dhe miratimit të Strategjisë

- Formimim i Këshillit për zbatimin e reformave në gjyqësor
- Zbatimi i kontrollit dhe mbikëqyrjes mbi sistemin për menaxhim të rasteve gjyqësore (AKMIS) për përcaktimin e keqpërdorimit dhe përgjegjësisë eventuale
- Mbështetje të plotë institucionale për punën e PSP, në përputhje me ligjet përkatëse
- Formimi i grupit të punës për përgatitjen e një propozim-teksti për ndryshimet e Ligjit për Mbrojtje të informatorëve në përputhje me rekomandimet e Komisionit të Venedikut dhe KE-së
- Përgatitja e një propozim-ligjit të ri për mbrojtje të dëshmitarëve
- Formimi i një grupi pune për të shqyrtuar rekomandimet e Komisionit të Venedikut lidhur me Ligjin për mbrojtje të privatësisë dhe do të përgatiten propozime dhe rekomandime për aktivitete të mëtejshme
- Përforsimi i kapaciteteve kadrovike të Avokatit të Popullit

Qeveria vlerëson **se reforma e shërbimeve të sigurisë dhe inteligjencës**, është më se e nevojshme. Duke pas parasysh se bëhet fjalë për reformë gjithëpërfshirëse, Qeveria do të sigurojë debat transparent dhe gjithëpërfshirës, në të cilin procesi i konsultimeve do të zbatohet në mënyrë përkatëse. Reformat do të kryhen në mënyrë të veçantë dhe në terren, dhe pasi që të kemi siguruar një pasqyrë, plan dhe dinamikë të qartë për ndryshimet e nevojshme, me çka do t'i mënjanojmë arsyet e shfaqjes së dobësive në mekanizmin e sigurisë dhe shërbimet e inteligjencës dhe do të rivendosim besimin në to.

- Fillimi i diskutimit gjithëpërfshirës në Parlament për zgjedhjen e modelit për reformë të sistemit për ndjekje të komunikimeve
- Përgatitje e një plani për zbatim të rekomandimeve të grupit të ekspertëve të lartë për çështje sistemore të sundimit të ligjit lidhur me ndjekjen e komunikimeve (2015), me një listë të akteve ligjore, masave administrative dhe teknike dhe implikimeve financiare
- Funkcionalizimi i Qendrës Koordinuese Nacionale për Luftë kundër Krimin të Organizuar
- Përcaktimi i modelit dhe kornizës ligjore për një mekanizëm të pavarur të jashtëm të mbikëqyrjes së punës së policisë, në bashkëpunim me Këshillin e Evropës dhe Avokatin e Popullit
- Formimi dhe emërimi i anëtarëve të Komitetit Nacional për luftimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon drejt terrorizmit
- Emërimi i Koordinatorit Nacional për parandalim të ekstremizmit të dhunshëm dhe luftës kundër terrorizmit dhe zëvendësve të tij

Qeveria do të kujdeset që lufta kundër krimin të organizuar dhe korrupsionit, nga letra të transferohet në praktikë, me lirin e mekanizmave nga ndikimi dhe presioni politik. Do të definojmë dhe implementojmë reforma që do të sigurojnë qëndrim të paanshëm dhe profesional ndaj çdo rasti të raportuar të korrupsionit, me qasje të

barabartë dhe aplikim të ligjit për çdo qytetar të vendit. Këtë do ta bëjmë në mënyrë transparente dhe me respektim të plotë të të gjitha rekomandimeve që vijnë nga ekspertë vendas dhe të huaj dhe nga shoqëria civile.

- Fillim me reforma në Departamentin për luftë kundër korrupsionit në Ministrinë e Punëve të Brendshme
- Qeveria kërkon nga Komisioni Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit të përgatisë një raport analitik të hollësishëm për të gjitha procedurat dhe hetimet e iniciuara për korrupsion gjatë 5 viteve të fundit, sipas formatit të KE
- Përforcimi i Policisë Financiare dhe krijimi i grupit punues ndërinstitucional për përforcimin e kapacitetit dhe ekspertizës për kryerjen e hetimeve dhe konfiskimin e pasurisë në bazë më sistematike
- Sigurimi i pajisjeve/qasjes dhe stafit të nevojshëm për kryerjen e ndjekjes së komunikimeve të Drejtorisë Doganore dhe Policisë Financiare, varësisht nga modeli i zgjedhur për reformë të shërbimeve të inteligjencës

Në fushën e **migracionit**, Qeveria do të fillojë negociatat me Komisionin Evropian mbi Marrëveshjen statutore për (FRONTEX) Shërbimin Evropian për gardën kufitare dhe bregdetare, sepse konsideron se kjo është me interes të përbashkët për ne dhe për BE-në.

- Formimi i një ekipi negociues, miratimi i pozicioneve negociuese dhe hapja e negociatave mbi Marrëveshjen statutore me Agjencinë Evropiane për Gardën Kufitare dhe Bregdetare
- Inicimi i takimeve teknike me KE-në për harmonizim të sistemit nacional me kërkesat përkatëse të rregullave të BE-së dhe të Shengenit
- Formimi i një njësie speciale (Task Force) për luftimin e trafikimit me njerëz dhe kontrabandimit të emigrantëve, i përbërë nga përfaqësues të Prokurorisë Themelore Publike për luftë kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe MPB -së
- Organizimi i një seminari rajonal me pjesëmarrje të koordinatorëve nacional të Ballkanit Perëndimor dhe BE-së për të luftuar trafikimin e njerëzve
- Rishikimin e Ligjit për azil dhe mbrojtje të përkohshme siç rekomandohet nga ekspertët e KE-së

Krahas këtyre prioriteteve, sigurisht që nuk do t'i harrojmë edhe **angazhimet e tjera të ndërmarra** dhe paralelisht do të punojmë në implementimin e tyre në interes të të gjithë qytetarëve të Republikës së Maqedonisë.